



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 38 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 13 dhe 14 të Ligjit për Procedurën Administrative nr.02/L28 dt. 22.07.2005, nenit 17 paragrafi 1 pika "b","d" dhe "e" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 dt. 20.02.2008, dhe nenit 57 shkronja "c" të Statutit të Komunës së Prishtinës nr.01-110-391 dt. 25.02.2010, duke vendosur sipas kërkesës me nr. 05 nr. 351-30622 dt. 13.03.2013, në emër të Nexhmije Rexhepi nga Prishtina dhe investitorit „Pozhegu Brothers” Sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit i Komunës së Prishtinës, merr këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET Nexhmije Rexhepi nga Prishtina dhe investitorit „Pozhegu Brothers” Sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, përdorimi dhe shfrytëzimi i objektit shumëbanesor (objektit 1 2B+P+5+Nk dhe 2 B+P+5+Nk si dhe 2 garazhave nëntokësore, sipas projektit ideor të miratuar), të ndërtuar në ngastrat kadastrale nr. 645/2, 645/3, 645/4 dhe 645/5, të evidentuar në fletën poseduese nr.1595, Zona Kadastrale Matiçan, në bllokun urbanistik „A8” të tërësisë urbane „A” të Planit Rregullues „Mati 1”, i ndërtuar sipas Lejes së Ndërtimit me nr. 05-351-17030 dt. 28.12.2010, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

II. Objekti do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje nga pika I dhe dokumentacionin teknik .

III. Objekti nga pika I. e këtij Aktvendimi mund të përdoret dhe shfrytëzohet nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktvendimi.

IV. Ky Aktvendim do të shërbejë si bazë për regjistrimin e objektit të përshkruar në pikën I të këtij Aktvendimi në evidencat përkatëse Kadastrale.

Arsyetim

Nexhmije Rexhepi nga Prishtina dhe investitorit „Pozhegu Brothers” Sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, me kërkesën 05 nr. 351-30622 dt. 13.03.2013, i është drejtuar Drejtorisë për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës Prishtinës, me të cilën ka kërkuar lëshimin e lejes së përdorimit dhe shfrytëzimit të objektit 1 2B+P+5+Nk dhe 2 B+P+5+Nk si dhe 2 garazhave nëntokësore, sipas projektit ideor të miratuar, të ndërtuar në ngastrat kadastrale nr. 645/2, 645/3, 645/4 dhe 645/5, të evidentuar në fletën poseduese nr.1595, Zona Kadastrale Matiçan, në bllokun urbanistik „A8” të tërësisë urbane „A” të Planit Rregullues „Mati 1”, i ndërtuar sipas Lejes së Ndërtimit me nr. 05-351-17030 dt. 28.12.2010, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, me që rast ka dorëzuar këtë dokumentacion:

- o Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të objektit investues të dt.14.02.2013.
- o Dokumentacioni përcjellës teknik të lidhura si libër(kopja e Lejes së ndërtimit,Lejes urbanistike, etj)
- o Certifikatat dhe atestet të lidhura si libër.

Drejtoria e Urbanizmit Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, pas shqyrtimit të provave të lëndës e konkretisht, procesverbalin e komisionit për kontrollim teknik të dt. 14.02.2013, si dhe dëshmitë e realizuara të propozuara nga komisioni për pranim teknik, ku secili anëtar ka bërë kontrollimin teknik të objektit ndërtimor investues dhe kanë konstatuar se, objekti investues është ndërtuar në pajtim me aktvendimin e cekur më lartë dhe dokumentacionin tjetër teknik dhe se i njëjti përmbushë normativat dhe standardet, aplikimi i të cilave është i domosdoshëm me rastin e ndërtimit të objekteve të tilla, për çka edhe ka propozuar që Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, t'i lëshoj lejen e përdorimi dhe shfrytëzimit, andaj kjo Drejtori vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Udhëzimi juridik: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përmes kësaj Drejtorie në afat brenda prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktvendimi.

I dorëzohet: Investitorit, kadastër dhe në lëndë arkivit.

**DREJTORIA E URBANIZMIT, NDËRTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
TË KOMUNËS SË PRISHTINËS 05 nr. 351-30622 dt. 26.03.2013**

E punoi:
F.Rahmani jur.dip.

FR

E kontrollloi:
Ferit Fazliu, idn

Ferit Fazliu

DREJTOR
Behxhet Mustli jur.dipl



2

01/07/13

26-03-2013

Prishtina/Opstina Prishtina/Pristina Municipality